

BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL DHE NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ndërmjet komunave ndodh kur dy ose më shumë qeveri lokale punojnë bashkë për të gjetur zgjidhje të përbashkëta për probleme të njëjta ose kur bashkërisht sigurojnë një shërbim në dobi të të gjitha komunave që janë të përfshira. Bashkëpunimi ndërkomunal mund ti ndihmojë qeveritë lokale për të rritur efikasitetin e tyre, përmirësuar menaxhimin e çështjeve lokale dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve komunale.

Për më tepër, themelimi i AKM-së i cili administron ndërmarrjet komunale që kanë funksionuar si Ndërmarrje që janë Pronë Publike dhe Ndërmarrjet që janë Pronë Shoqërore deri më 23 mars 1989 praktikisht ua ka hequr komunave mundësinë e administrimit të këtyre shërbimeve të rëndësishme publike dhe si rezultat i ka privuar ata nga administrimi i përbashkët i ndërmarrjeve të ujësjellesave dhe rrjetit të ujërave të zeza. Kontrolli i vazhdueshëm i AKM-së mbi këtë element të rëndësishëm të çështjeve lokale mund të konsiderohet si një pengesë objektive për bashkëpunimin ndërkomunal dhe si ndërhyrje e panevojshme e qeverisë qendore në autonominë e qeverisjes lokale.

Situata nuk është e ndryshme përse i përket bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar, i cili deri tani nuk është shumë i zhvilluar dhe shpesh karakterizohet nga mungesa e institucionalizimit. Disa komuna të Kosovës kanë filluar të bashkëpunojnë ose janë në proces të vendosjes së kontakteve me homologët e tyre ndërkombëtar. Këto kontakte janë formuar nga vetë komunat ose përmes udhëheqjes së Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Me përjashtim të projektit të bashkëpunimit të Gjilanit, Preshevës, Kumanovës, Tergovishtes i njohur ndryshe me emrin Iniciativa GPKT nuk ka asnjë projekt domethënës të bashkëpunimit ndërkomunal vendor ose ndërkombëtar në fushat tjerat të çështjeve lokale.

Karta Evropiane mbi Vetë-Qeverisjen Lokale

Neni 10 i Kartës paraqet të drejtën e bashkëpunimit ndër-komunal, i cili mund të merr formën e krijimit të konsorcimeve ose bashkësive të autoritete lokale për të ushtruar funksionet e përbashkëta përbrenda kufijve të caktuar nga legjislacioni në fuqi. Paragrafi 1 i Neni 10 mbulon bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve lokale në fushat e caktuara me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe përmbushjes së detyrave të cilat janë të vështira për tu kryer nga një komunë e vetme. Raporti Shpjeguesi Kartës konstaton se një bashkëpunim i tillë mund të marr formën e krijimit të partneritetit ose formave tjera në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të secilit shtet. Paragrafi 2 parashikon të drejtën e komunave për të krijuar shoqata jo vetëm për të bashkëpunuar në fushat e caktuara të mandatit të tyre por edhe për të përfaqësuar interesat e të gjitha autoriteteve lokale në shtetin ose rajonin përkatës. Sipas Kartë, e drejta për ti takuar shoqatave nuk është e kufizuar vetëm për autoritetet kombëtare, pra komunat kanë të drejtë për të qënë anëtarë të shoqatave ndërkombëtare. *Paragrafi 3 është lidhur me bashkëpunimin direkt të komunave të një shteti me autoritetet individuale lokale të shteteve tjera jo vetëm të zonave kufitare.*

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/25 “Mbi Vetë-Qeverisjen e Komunave në Kosovë”, e cila i paraprin Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 “Korniza Kushtetuese e Kosovës” parashikon të drejtën e komunave për të bashkëpunuar ndërmjet tyre për zbatimin e kompetencave dhe përgjegjësive të tyre përveç në disa fusha specifike duke përfshirë menaxhimin buxhetor, fiskal, të brendshëm dhe aprovimin e simboleve siç janë caktuar në Nenin 2 Paragrafi 11.3. Sipas kësaj Rregullore, Kuvendi Komunal ka të drejtën ekskluzive për të vendosur mbi bashkëpunimin ndërkomunal.

Rregullorja e UNMIK – ut 2007/30

Kjo rregullore nuk sjell kurrfarë risi në këtë drejtim përveç se ngjashëm sikur rregullorja 45/2000 parasheh se komunat në bashkëpunim me njëra tjetrën mund të lidhin marrëveshje për ushtrimin e cilësdo nga përgjegjësitë dhe kompetencat e veta.

Situata në Kosovë është mjaft ndryshe. Që nga themelimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV) më 2001, Qeveria e Kosovës ende nuk ka qenë në gjendje të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal të brendshëm dhe të jashtëm.

Situata nuk është e ndryshme për sa i përket bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar, i cili deri tani nuk është shumë i zhvilluar dhe shpesh karakterizohet nga mungesa e institucionalizimit. Disa komuna të Kosovës kanë filluar të bashkëpunojnë ose janë në proces të vendosjes së kontakteve me homologet e tyre ndërkombëtarë. Këto kontakte janë formuar nga vetë komunat ose përmes udhëheqjes së Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Me përjashtim të projektit të bashkëpunimit të Gjilanit, Preshevës, Kumanovës, Tërgovishtes, i njohur ndryshe me emrin Iniciativa GPKT, nuk ka asnjë projekt domethënës të bashkëpunimit ndërkomunal vendor ose ndërkombëtar në fusha të tjera të çështjeve lokale.

Situata aktuale kushtetuese dhe ligjore lidhur me bashkëpunimin ndërkomunal ende nuk është e zhvilluar dhe e detajuar sa e si duhet.

Bashkëpunimi ndërkomunal mund të përkufizohet si aktivitet i përbashkët ,që synon zhvillimin e lidhjeve ekonomike, sociale, teknike, kulturore dhe lidhjeve të tjera ndërmjet autoriteteve lokale të Kosovës me njëra tjetrën dhe marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve lokale të Kosovës dhe autoriteteve përkatëse të shteteve të huaja brenda kompetencave të siguruara për legjislacionin e tyre përkatës vendor. Nga përkufizimi i mësipërm vërehet qartë se ekzistojnë dy kategori të bashkëpunimit ndërkomunal;

1) bashkëpunimi ndërmjet komunave të të njëjtit shtet (bashkëpunimi vendor ndërkomunal) dhe

2) bashkëpunimi ndërmjet komunave të shteteve të ndryshme (bashkëpunimi ndërkombëtar ndërkomunal).

Qëllimi kryesor i çfarëdo forme të bashkëpunimit ndërkomunal është krijimi i marrëdhënieve ose lidhjeve kontraktuese për të gjetur zgjidhje të përbashkëta për probleme të ngjashme ose për të ndihmuar njëri tjetrin në përmbushjen e përgjegjësisë së tyre. Prandaj, bashkëpunimi ka të bëjë më shumë me ushtrimin e kompetencave bashkërisht mbi baza funksionale sesa me lidhje në baza politike. Përbrenda dy kategorive, ka disa forma të bashkëpunimit ndërkomunal.

Në tabelën vijuese do të ilustrojmë bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkombëtar të komunave të Kosovës.

Bashkëpunimi i komunave të Kosovës me komunat ndërkombëtare, ndërkufitare dhe ndërkomunale

Emri i komunës	Komunat e binjakëzuara ndërkombëtare	Bashkëpunim pa binjakëzim	Marrëveshjet nënshkruara për bashkëpunim ndërkombëtarë	Marrëveshjet për bashkëpunim ndërkomunal	Lloji i aktivitetit
Gjakovë	James Toën(Sh.B.A) Odunpazar Eskeshehir(Turqi) Kavajë(Shqipëri)				
Obiliq		Lilihamer (Norvegji)			Hapja e zyrës për biznese të vogla dhe të mesme në Obiliq
Malishevë	Nuk ka pasur ndonjë binjakëzim				
Prizren	Konak - Izmir(Turqi)				
Fushë-Kosovë	Stange(Norvegji) CDF		19.9.2006(Stange) 1.6.2006	17.5.2006(Prishtinë)	Administratë lokale,bashkëp. ekonomik Pastrimi I lagjeve dhe vendosja e kontenierëve Transport rrugor të udhëtarëve

Gjilan	Iper(Belgjik) Yellderum(Turqi) Kukës (Shqipëri)		Kumanovë(Maqedoni) Preshevë(Serbi) Tërgovishtë(Serbi)	Novobërdë	
Suharekë	Nuk është e binjakëzuar me asnjë komunë dhe s'ka bashkëpunime				
Klinë	Pisa(Itali)				
Mitrovicë	Allasehir(Turqi) Hassleholm(Suedi) Korçë(Shqipëri)	Frederikstadet(Norvegji) Bassano Del Grappa(Itali)	12.03.2003		Bashkëpunim ekonomik dhe kulturor
Drenas	Londer(Angli) Stamboll(Turqi) Pukë(Shqipëri)				
Istog	Huntington-Éoods(Sh.B.A)				
Kamenicë	Nuk ka pasur ndonjë binjakëzim				
Deçan	Groseto (Itali)				
Dragashë	Etimesgut(Turqi) Vaxjo(Suedi)	Columbia(SHBA)			
Ferizaj	Terni (Itali) Shkodër (Shqipëri)	Tongeren (Belgjikë)			
Kaçanikë	Moosseedorf (Zvicër)	Berat(Shqipëri)			

Lypjan				
Pejë	Molls- 5 bashki(Belgji k) Singen (Gjermani) Trontino dhe Bergamo(Gjer mani) Jeams Ford,Ecsesi(B ritani e Madhe) Durrës(Shqipë ri) Ulqin, Rozhajë(Mali i Zi) Bujanoc Tetovë, Gostivar(Maq edoni)				
Podujevë		Landi I Tiroli(Aust ri) Manchester Aid(B.Mad he)			
Prishtinë	Ankara (Turqi) Budapest(Hun gari)				
Rahovec	Niel (Belgjikë) Nova Gorica(Slllove ni) Morten(Zvice rr)				

Shtime	Tameside(An gli) Zharpen (Belgjikë)	Sarandë(Sh qipëri) Buqa Shirinja(Tu rqi) Selquk(Tur qi)			Shkëmbim i eksperiencave në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe urbanizmit
Skënderaj	Beverungen(Gjermani)				Furnizim me pajisje mjekësore
Viti		Karlova (Bullgari) Emertal (Gjermani) Sindriq(Tur qi) Haraqinë(Maqedoni) Lecco(Itali) Fier(Shqipë ri) Kavajë(Shq ipëri) Lushnjë(Sh qipëri) Umea(Sued i)			
Vushtrri	Ootzaan(Hola ndë) Mamak- Ankara(Turçi) Kavajë(Shqip ëri)				
Shtërpcë	Nuk ka pasur ndonjë binjakëzim				
Novoberdë				Gjilan Kamenicë	

Mamushë	Kucuk Cekmece (Turqi) Osmangazi (Turqi) Tekirdag (Turqi)				
----------------	--	--	--	--	--

Siç po shihet nga tabela, më shumë ka raste të bashkëpunimit ndërkombëtar në formë të binjakëzimit të qyteteve apo partneritetit. Është shumë evidente se format dhe mundësitë e bashkëpunimit ndërkomunal nuk janë të shfrytëzuara në mënyrë të duhur. Sferat e ndryshme në kuadër të përgjegjësiave të komunave, sidomos ato të shërbimeve publike komunale po edhe të arsimit , shëndetësisë, etj., me një bashkëpunim më të mirë të komunave, mund të menagjohen më mirë dhe të racionalizohen.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i komunave, në çfarëdo forme qoftë, nuk është kuptimplotë dhe nuk është në kuptim të promovimit të vlerave që parasheh Karta Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale apo në funksion të krijimit të praktikave të qeverisjes së mirë, bashkëpunimit të përhershëm dhe afatgjatë, duke këmbyer përvojën dhe ekspertizën, por më shumë është në funksion të gjetjes së mënyrave të përkrahjes të projekteve të caktuara.

Gjithashtu, bashkëpunimi ndërkombëtar duhet koordinuar nga niveli qendror, e kjo në periudhën e gjertanishme nuk ka qenë e tillë.

Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale

Ligji i ri mbi Vetëqeverisjen Lokale i jep hapësirë të konsiderueshme bashkëpunimit ndërkomunal dhe aranzhimeve tjera ndërkomunale duke i paraparë të gjitha format e bashkëpunimit të parapara me Kapitullin V të këtij ligji.

Bashkëpunimi ndërmjet komunave të Kosovës

Komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe krijojnë partneritete me komunat tjera të Kosovës, brenda fushës së kompetencave të tyre, për

kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët në pajtim me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe në pajtim me ligjin.

Partneritetet komunale

Përgjegjësitë komunale në fushën e kompetencave të tyre vetanake dhe të zgjeruara, me përjashtim të atyre të shënuara në nenin 40.2 të këtij ligji, mund të ushtrohen përmes partneriteteve komunale.

Aktivitetet e partneriteteve financohen përmes buxheteve komunale të komunave pjesëmarrëse.

Partneritetet komunale mund t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për jetësimin dhe ushtrimin e bashkëpunimit funksional përmes, *ndërmjet tjerash*, themelimit të një organi vendimmarrës, të përbërë nga përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse, punësimit dhe shkarkimit të personelit administrativ dhe këshilldhënës dhe vendimeve mbi nevojat për financim dhe nevojave të tjera operationale të partneritetit.

Vendimet për partneritet u nënshtrohen mbikqyrjes së ligjshmërisë në pajtim me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

Bashkëpunimi ndërkufitar i komunave

Komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me organe të huaja të vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e kompetencave vetanake komunale dhe kompetencave të zgjeruara, me përjashtim të atyre në nenin 40.2 të këtij ligji.

Komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë, brenda kompetencave të tyre, me komunat dhe institucionet, përfshirë agjencitë qeveritare të Republikës së Serbisë. Bashkëpunimi i tillë do të ketë formën e ofrimit të asistencës financiare dhe teknike nga ana e institucioneve të Serbisë, duke përfshirë personelin e specializuar dhe pajimet, në zbatimin e kompetencave komunale.

Komunat duhet ta njoftojnë ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale për çdo synim të bashkëpunimit ndërkufitar. Njoftimi përfshin draft marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe partnerëve të propozuar.

Draft marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet komunave do të përmbajë elementet në vijim:

- i. Emrat e komunave që lidhin marrëveshjen;
- ii. Datën e synuar të marrëveshjes;
- iii. Fushat e parashikuara dhe objektivat e bashkëpunimit;
- iv. Modalitetet për ofrimin e stafit dhe pajisjeve, nivelin e financimit, e mekanizmat e financimit dhe marrëveshjen procedurale, në pajtim me kërkesat e menaxhimit publik financiar, që zbatohen për të gjitha komunat.

Pas shqyrtimit të draft marrëveshjes, ministria përgjegjëse për qeverisje lokale mund të kërkojë ndryshime të draft marrëveshjes për bashkëpunim, nëse konsideron se ka shkelja serioze e ligjit dhe nuk mund të rregullohet ndryshe, ministria mund ta suspendojë bashkëpunimin e synuar.

Komuna mund ta kundërshtojë një veprim të tillë të ministrisë në Gjykatën e Qarkut, kompetent për territorin e komunës.

Partneritetet ndërmjet komunave të Kosovës do të kenë të drejtë për marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet e Republikës së Serbisë vetëm deri në masën e nevojshme për zbatimin praktik të aktiviteteve të partneritetit.

Të drejtat e komunave për të formuar asociacione

Për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta, komunat formojnë dhe marrin pjesë në asociacionet që funksionojnë, në pajtim me ligjin.

Asociacionet e komunave të Kosovës

Komunat individuale mund t'i bashkohen asociacioneve përfaqësuese të organeve vetëqeverisëse lokale të Kosovës.

Aktet inkorporuese dhe dokumentet financiare të asociacioneve të tilla duhet të bëhen publike. Komunitat pjesëmarrëse duhet ta bëjnë publik informacionin për aktivitetet e komunave të tilla si dhe kontributet e tyre buxhetore që u japin asociacioneve.

Asociacionet e tilla mund t'u ofrojnë anëtarëve të tyre një numër shërbimesh, duke përfshirë trainimin, ngritjen e kapaciteteve, ndihmën teknike dhe hulumtim në kompetencat komunale dhe rekomandimet politike, në pajtim me ligjin.

Asociacionet ndërkombëtare të autoritetve lokale

Asociacionet e komunave të Kosovës mund të bashkëpunojnë me asociacionet ndërkombëtare të autoriteteve lokale.

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane

Çdo komunë mund të bëjë marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë banorëve të komunës

Me aprovimin e komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, vetë apo në mënyrë të kombinuar, mund të kryejnë aktivitete që bëjnë pjesë në përgjegjësitë dhe në kompetencat e komunës. Në këtë rast, komunitat ofrojnë burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale lëshon udhëzime për marrëveshjet ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve.

Statuti dhe rregulloret lokale komunale e përcaktojnë formën e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe fushën e punës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane e respektojnë ligjin në fuqi gjatë kryerjes së aktiviteteve sipas marrëveshjes me komunën.